



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.481/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Ferit Osmani dhe Vllastimir Dimiq, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Marjan Lubiq nga subjekti politik Srpska Socialdemokratska Stranka (SSDS) me seli në Shtërpçë, paraqitur kundër Branislav Nikolliqit dhe truprojave të tij për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Marjan Lubiq

ARSYETIMI

Më datën 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Marjan Lubiq i cili thekson se në dhomën ku është zhvilluar votimi rreth orës 8:30, ka hyrë kryetari i komunës me truprojat e tij dhe e ka sulmuar fizikisht. Parashtruesi i ankesës thekson se është rrëzuar në tokë, ku me pas është shkelmuar dhe grushtuar. Dhoma ka qenë plot me njerëz (kontrolluesit dhe vëzhguesit) të cilët nuk kanë guxuar ta ndihmojnë dhe ti ofrojnë ndihmë mjekësore, për shkak se kanë qenë të frikësuar nga ana e kryetarit të komunës. Parashtruesi gjithashtu thekson se kolegu i tij partiak është nxjerrë jashtë dhomës duke u kërcënuar

Ne mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove materiale.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, ne rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton se ankesa është e parregullt për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkakun se parashtuesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsitë e pretenduara. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 481/2010 më datën 14.12.2010

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

